



SHTYLLAT



E DEMOKRACISË

QEVERISJE E POPULLIT

ELON (11), SOMEA (10), ALMA (10), XHENISA (11), ERZA (10), ORGES (10), ROBERT (10)




Nga ne do të mësoni se si populli ka fuqi të vendos për të ardhmen e vet

Populli vendos për të ardhmen e vet përmes pjesëmarrjes aktive në procesin zgjedhor. Zgjedhjet janë formë e demokracisë. Demokracia është sistem i qeverisjes ku populli ka fuqinë më të madhe. Në demokraci secili e shpreh mendimin e vet lirshëm, prandaj demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes. Demokracia për herë të parë është paraqitur në Athinë në vitin 507 para erës së re. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke ku „demos“ do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë qeverisje apo pushtet. Në filltet e para të demokracisë nuk kishte demokraci të plotë, sepse kanë pasur të drejtë të votojnë vetëm burrat dhe të pasurit. Kurse tash, të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare kanë të drejtë të votojnë. Disa nga elementet e demokracisë janë: toleranca, paqja, liria, respekti, edukata, zgjedhja, drejtësia, mendimi i lirë, sovranite-

ti, përgjegjësia, pushteti, barazia, solidariteti etj. Janë dy lloje të demokracisë: demokracia e drejt-përdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Po ashtu, demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: demokracia përfaqësuese parlamentare dhe demokracia përfaqësuese presidenciale. Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare, ku populli i zgjedh deputetët kurse deputetët e zgjedhin Presidentin. Edhe një element shumë i rëndësishëm i demokracisë që ia vlen të ceket është edhe barazia, që nënkupton se të gjithë jemi të barabartë pa dallim race, gjinie, feje etj.

Prandaj lexues të dashur, ne duam që të jetojmë në një shtet demokratik. Por, për të pasur demokraci të plotë duhet edhe kontributi ynë sepse ne jemi ata të cilët e fuqizojmë demokracinë. Të gjithë ne duhet t'i respektojmë parimet e demokracisë në mënyrë që shteti ynë të funksionoj sa më mirë.



Ilustrim i autorëve të artikullit



Gazetarët e së ardhmes

ZGJEDHJET DEMOKRATIKE

IRENA (10), AMANDA (10), FEHARI (11), EGZONI (10), ERZA (10), BELTINA (10)

Zgjedhjet e qytetarëve


Demokraci do të thotë liri. Ne kur zgjohe mi në mëngjes zgjedhim si të vishemi, si të ushqehemi etj. Pra ne në jetën e përditshme jemi të lirë që të zgjedhim sipas dëshirës tonë.

Në zgjedhjet demokratike voton populli dhe aty votohen përfaqësuesit të cilët quhen deputetë. Po ashtu që ne të votojmë duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare sepse atëherë jemi më të pjekur dhe e dimë se kë të zgjedhim apo votojmë. Gjithashtu kemi dy lloje të zgjedhjeve siç janë: zgjedhjet komunale, ku votohet kryetari i komunës dhe asambleistët, dhe zgjedhjet qendrore, ku populli zgjedh deputetët.

Grupi ynë shpreson që ky artikull t'iu informoj për zgjedhjet demokratike.



Gazetarët duke punuar



Vota jonë bën ndryshimin



Këtu është paraqitur një kandidat për deputet



Në këtë vizatim është paraqitur procesi zgjedhor



Ne jemi të lirë të zgjedhim atë që dëshirojmë

NJERËZIT DHE PLANETI

ALMA (11), NJOMZA (10), MILOT (10), ELMEDIN (11), ERMAL (10), EGZONA (10), ERA (10)

Ne si gazetarë të vegjël filluam të shkruajmë për familjen, lagjen, qytetin, shtetin, kontinentin dhe për planetin tonë. Në artikull ne kemi paraqitur disa ide se si mund t'iu ndihmojmë të gjithë njerëzve


Qytetari është një pjesëtar i komunitetit të Kosovës. Komunitet quajmë një shtëpi, një shkollë, një lagje, apo një grup tjetër. Lagjja është një komunitet i vogël, aty duhet të ketë rregulla dhe respekt për njëri-tjetrin. Në rrugë duhet të respektohen shenjat e komunikacionit, sepse nëse nuk i respektojmë ato mund ta dëmtojmë veten dhe të tjerët. Shteti është një vend i madh me shumë qytete. Në ato qytete ka edhe shumë fshatra të ndryshme, të cilat duhet të jenë të pastërta. Kosova me territor bën pjesë në Evropë, mirëpo ne dëshirojmë që ajo të pranohet edhe në Bashkimin Evropian, por për këtë duhet të plotësojmë disa kushte. Toka jonë është e mbuluar me plot shtete të ndryshme, ku jetojmë të lumtur dhe në harmoni të gjithë njerëzit, kafshët dhe bimët.




Çfarë mund të bëjmë ne për planetin tonë?



Unë bëj shumë për familjen time



Ne jemi pjesë e banorëve të lagjes



Edhe pse fëmijë, ne kemi përgjegjësi ndaj qytetit tonë



Gazetarët e vegjël të demokracisë

NDARJA E PUSHTETIT NË VENDIN TONË

EDONA (10), BETIM (10), KLITINA (10), REDON (10), ERA (10), DRILON (10), RINESA (10)

Ne si gazetarë kemi marrë informata për ndarjen e pushtetit në Kosovë. Ju ftojmë që edhe ju lexues të dashur të merrni disa informata prej artikullit tonë më poshtë

Në shtetet demokratike, ashtu siç është edhe Kosova, pushteti ndahet në tri degë. Këto tri degë të pushtetit janë: pushteti Legjislativ i cili ndryshe quhet Kuvendi, pushteti Ekzekutiv që është Qeveria dhe pushteti tjetër është pushteti Gjyqësor. Kjo ndarje e pushtetit bëhet për shkak që secili prej tyre duhet t'i ketë detyrat dhe përgjegjësitë e ndara. Në Kuvendin e Kosovës punojnë deputetët. Detyrat e deputetëve janë: të përfaqësojnë shtetin dhe popullin, të miratojnë, shfuqizojnë dhe propozojnë ligje, të mbikëqyrin punën e Qeverisë, zgjedhin Qeverinë dhe Presidentin. Në Kuvendin e Kosovës janë 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë qytetarë shumicë dhe 20 prej tyre janë nga komunitetet jo shumicë, si serbët, romët, turqit etj.

Qeveria e cila është pushteti Ekzekutiv zgjedhet nga Kuvendi. Në Qeveri punojnë Kryeministri, ministrat, zëvendësministrat etj. Kuvendi i miraton ligjet, kurse Qeveria i realizon ato. Qeveria ka për detyrë t'iu siguroj kushte sa më të mira qytetarëve të saj. Disa nga ministritë në Qeverinë e Kosovës janë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, etj.

Në sistemin gjyqësor në Kosovë bëjnë pjesë tri gjykata. Ato janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Në një seancë gjyqësore marrin pjesë gjykatësi, avokati dhe i pandehuri, kurse prokurorët janë ata të cilët i hetojnë rastet e dyshuara.



Kuvendi,
i cili është pushteti
Legjislativ, që ndryshe quhet
edhe Shtëpia e Popullit

Redoni duke bashkëbiseduar me shokë



Unë e
kam kuptuar që degët tjera
të pushtetit janë Ekzekutivi dhe
Gjyqësori

Driloni iu tregon shokëve për Qeverinë dhe Gjyqësorin



Hmmm... qenkan tri
degë të pushtetit, Kuvendi, Qeveria dhe
Gjyqësori

Betimi e kupton se qenkan tri degë të pushtetit



Gazetarët e këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Afrim Gashi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Hajvali, Prishtinë